




Saimir Tahiri

ISH-MINISTËR I BRENDSHËM

Deklaratat e analizuara:

11 Deklarata te analizuara
(nga deklarimi Për Herë të Parë 2010 deri Periodik/Vjetor 2018)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018




↗ Pasuria bruto është rritur 1.5 herë.

+ 845,661 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2010-2018	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	14,562,022	50.78%
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	13,689,627	47.74%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	425,792	1.48%
Total	28,677,441	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 9 vit rezultoi:

1 deklaratë Me Probleme
8 deklarata Pa Probleme

Subjekti Saimir Tahiri në vitin 2017 rezultoi me burime financiare të pamjaftueshme për të mbuluar shtesat e aseteve në vlerë 3,399,483 lekë (pa llogaritur në këtë analizë shpenzimet e konsumit familjar).

Në vitin 2015, subjekti deklaroi marrjen e një kredie në vlerën 2,100,000 lekë për shlyerjen e një detyrimi financiar, e rikthyer për mosrealizim të qëllimit në fund të vitit 2015. Tahiri deklaroi se pas marrëveshjes në zyrën përmbartimore, detyrimi do të shlyhet çdo muaj në llogarinë e paditësve.

Subjekti dhe bashkëshortja e tij i deklarojnë llogaritë bankare herë si gjendje në fund të vitit, herë si shtesë/pakësim krahasuar me deklarimin paraardhës, gjë që bën të vështirë arritjen e konkluzioneve të sakta lidhur me likuiditetet bankare. Nisur nga analiza aritmetike, subjekti deri në vitin 2017 rezultoi me gjendje likuiditetesh bankare në shumën 14,241,019 lekë, ndërkohë që në vitin 2018, ai deklaroi si gjendje totale vlerën 9,394,595 lekë.

